



PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL NË SHQIPËRI

**Thirrje për Aplikime për
Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin**

15 Korrik 2021

Projekt i:



Zbatuar nga:



Në bashkëpunim me:



Tabela e Përmbajtjes

| | | |
|--------------|--|----|
| 1 | INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR SKEMËN E GRANTEVE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN | 3 |
| 1.1 | Konteksti dhe qasja | 3 |
| 1.2 | Strukturat drejtuese | 4 |
| 1.3 | Alokimi financiar i mundësuar nga Donatorët | 5 |
| 1.4 | Përzgjedhja e projekteve, akordimi i grantit dhe pagesa e fondeve të grantit | 5 |
| 2 | RREGULLAT E SKEMËS SË GRANTEVE PZHRSH PËR ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN | 7 |
| 2.1 | Kriteret e lejueshmërisë | 7 |
| 2.1.1 | Kriteret e lejueshmërisë për aplikantët (aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikant(ët)) | 7 |
| 2.1.2 | Projektet e lejuara: Projektet për të cilat mund të bëhet aplikimi | 8 |
| 2.1.3 | Lejueshmëria e kostove: kostot që mund të mbulohen nga granti | 11 |
| 2.2 | Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur | 12 |
| 2.2.1 | Projekt ideja (concept note) | 12 |
| 2.2.1.1 | Ku dhe si t'i dërgoni projekt idetë | 13 |
| 2.2.1.2 | Afati për dorëzimin e projekt ideve | 13 |
| 2.2.1.3 | Informacione të tjera për projekt idetë | 13 |
| 2.2.2 | Aplikimi | 14 |
| 2.2.2.1 | Ku dhe si t'i dërgoni aplikimet | 14 |
| 2.2.2.2 | Afati për dorëzimin e aplikimeve | 15 |
| 2.2.2.3 | Informacione të tjera për aplikimet | 15 |
| 2.3 | Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve | 15 |
| 2.4 | Njoftim për vendimin e Autoritetit Kontraktues | 21 |
| 2.4.1 | Përmbajtja e vendimit | 21 |
| 2.4.2 | Paraqitja e dokumenteve shoqëruese për aplikimet e përzgjedhura përkohësisht | 21 |
| 2.5 | Tabela me afatet kohore | 21 |
| 2.6 | Nënshkrimi i kontratës së grantit | 22 |
| 2.7 | Kushtet për zbatimin pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për akordimin e grantit | 23 |
| 3 | LISTA E SHTOJCAVE | 23 |
| Shtojca 1: | Listë e mikro rajoneve të lejueshme për Programin "100 fshatrat" | 23 |
| Shtojca ACN: | Formulari i Aplikimit për Grant – Projekt Ide (në format Word-i) | 23 |
| Shtojca A: | Formulari i Aplikimit për Grant – Aplikimi i plotë (në format Word-i) | 23 |
| Shtojca A1: | Kuadri logjik (në format Word-i) | 23 |
| Shtojca B: | Buxheti (në format Excel-i) – kjo do të bëhet Shtojca II e Kontratës së Grantit | 23 |
| Shtojca C: | Kontratë tip i Grantit | 23 |
| Shtojca D: | Marrëveshje tip partneriteti për projektin | 23 |

1 Informacion i përgjithshëm për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

1.1 Konteksti dhe qasja

Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri, Faza IV, 2019-2023 (Programi ZHRSH), është një projekt i financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (Donatorët), i zbatuar në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare. Qëllimi i kryesor i Programit është të nxisë një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm social dhe ekonomik duke u mbështetur në tiparet dhe atributet e rajoneve, duke ruajtur e zhvilluar karakteristikat e tyre natyrore dhe kulturore, duke inkurajuar potencialin e tyre për zhvillim ekonomik për uljen e pabarazive në Shqipëri dhe duke ofruar kushte më të mira shoqërore dhe ekonomike për qytetarët shqiptarë.

Programi, që zbatohet në bazë të marrëveshjes dypalëshe mes Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, synon të rrisë kohezionin rajonal, të zvogëlojë pabarazitë në shfrytëzimin e burimeve, të rrisë produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, duke ofruar, nga ana tjetër, mbështetje të drejtpërdrejtë financiare në formën e granteve për autoritetet vendore, meqenëse këto të fundit janë aktorët aktivë në terren.

Sipas qasjes së aplikuar deri më sot, skema e re e granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin bazohet në nevojat prioritare dhe potencialet që kanë rajonet, të harmonizuara me strategjitë kombëtare dhe ato vendore, përfshirë këtu ato që lidhen me integrimin evropian dhe prioritetet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). E përcaktuar nga qeveria si institucioni përgjegjës për Politikën e Zhvillimit Rajonal, FSHZH hartoi një program kombëtar që pasqyron politikën e qeverisë shqiptare për zhvillimin socio-ekonomik të vendit me fokus në zonat rurale me "Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100 + Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026". Duke qenë se objektivat e programit të "100+ fshatrave" kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të Programit të PZHRSH, u propozua që skema e re e granteve të harmonizohet me Programin "100+ fshatrave".

Objekti dhe natyra e Skemës së Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin do të fokusohet në dimensionet e zhvillimit rajonal, nxitjen e institucioneve dhe partnerëve për bashkëpunim nëpërmjet projekteve ndërvendore që kanë një ndikim të qartë në zhvillimin rajonal.

Objektivat kryesorë të Skemës së Granteve të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit të Programit PZHRSH janë:

1. Të mbështesë qasjet e integruara që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve duke krijuar sinergji e duke plotësuar ndërhyrjet e përcaktuara në "Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100 + Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026";
2. Të rrisë potencialin ekonomik në mikro rajone¹ dhe të përmirësojë kapacitetet vendore e rajonale sipas nevojave dhe potencialeve të evidentuara në sektorë të tillë si: kultura, turizmi, kërkimi dhe zhvillimi, mbrojtja e mjedisit dhe edukimi, duke mbështetur nisma të nxitura nga politika zhvillimi dhe krijimi i rrjeteve social-ekonomike;
3. Të mbështesë zhvillimin social-ekonomik në mikro rajone nëpërmjet përmirësimit të aksesit të shërbimit sociale.

Për më shumë informacion për Programin ZHRSH dhe për Skemën e Granteve të këtij programi vizitoni faqen tonë në internet: www.rdpa.al.

¹ Siç përcaktohet në Shtojcën 1 në përputhje me "Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100 + Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026"

1.2 Strukturat drejtuese

Autoriteti Kontraktues

Fondacioni PZHRSH do të jetë Autoriteti Kontraktues për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin. Në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, Fondacioni PZHRSH:

- Do të përgatisë udhëzime dhe kriteret e pranimit për përfituesit e granteve;
- Do të mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes që do të ndjekë Enti i Deleguar dhe do të kryejë verifikime për të gjitha fazat e parashikuara të vlerësimit;
- Do të hartojë kontratat e granteve dhe amendimet e këtyre kontratave;
- Do të nënshkruajë kontratat e granteve dhe amendimet e këtyre kontratave;
- Do të sigurojë kontrollin financiar dhe të gjithë dokumentacionin e auditit në të gjitha entet e përfshira në proces;
- Do të kryejë kontrolle rastësore për dokumentacionin e pagesave/rimbursimeve që janë marrë nga përfituesit e granteve nëpërmjet Entit të Deleguar, si dhe do të verifikojë mjaftueshmërinë e dokumentacionit, saktësinë dhe ligjshmërinë e dokumenteve mbështetëse;
- Do të kryejë mbikëqyrjen e funksioneve të deleguara sipas Marrëveshjes së Delegimit;
- Do të raportojë për çdo parregullsi dhe do të sigurohet që përfituesi të rimburojë çdo shumë të përfituar në mënyrë të padrejtë e të financuar nga kontributi, si dhe do të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm tek kontrollorët dhe auditorët e jashtëm të autorizuar;
- Do të sigurojë vizibilitetin e Skemës së Granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

Enti i Deleguar

Për të zbatuar me efektivitet dhe efikasitet Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë Enti i Deleguar, i cili, mes të tjerave:

- Do t'u japë informacione aplikantëve për kushtet e financimit;
- Do të marrë dhe regjistrojë aplikimet;
- Do të krijojë Komisionin e Vlerësimit dhe do të përzgjedhë projektet në përputhje me kushtet dhe kriteret e shpallura në Thirrjen për Propozime;
- Do të mbështesë Autoritetin Kontraktues për finalizimin e kontratave të granteve për projektet e përzgjedhura;
- Do t'u japë udhëzime përfituesve të granteve, përfshirë këtu asistencë në përgatitjen e dokumenteve të prokurimit publik, tenderimin dhe akordimin e kontratave sipas rastit;
- Do të kryejë verifikimet e menaxhimit dhe dhënien e miratimit për pagesat dhe/ose rimbursimin e shpenzimeve të granteve;
- Do të bëjë monitorimin dhe raportimin për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;
- Do të sigurojë vizibilitetin e Skemës së Granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

Rrjedhimisht, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të luajë një rol kryesor si në përzgjedhjen e projekteve ashtu edhe në zbatimin e tyre.

Në kontratën e grantit do të përcaktohen përgjegjësitë e hollësishme të Autoritetit Kontraktues dhe Entit të Deleguar në raport me përfituesin e grantit. Përfituesit e Granteve do të menaxhojnë kontratën e grantit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri, përfshirë këtu prokurimin e shërbimeve, dhe/ose materialeve dhe/ose punimeve.

Komisioni i Vlerësimit

Komisioni i Vlerësimit do të krijohet nga FSHZH me qëllim vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekt propozimeve. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit do të garantojnë vlerësimin e tyre profesional, të paanshëm dhe konfidencial të projekt propozimeve. Komisioni i Vlerësimit mund të mbështetet nga ekspertizë teknike e jashtme e paanshme.

1.3 Alokimi financiar i mundësuar nga Donatorët

Shuma e përgjithshme e mundshme që ofrohet përmes kësaj Thirrjeje për Aplikime është 158.092.012 Lekë (1.421.600 franga zvicerane) pa TVSH. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos i akordojë të gjitha fondet në dispozicion.

Vlera e granteve

Bashkitë pjesë e “Programit për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100+ Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026” janë të vetmet që mund të aplikojnë dhe kanë të drejtë të përfitojnë nga ky grant.

Në qoftë se është vetëm **një bashki** që aplikon në këtë thirrje për aplikime, çdo grant i kërkuar duhet të jetë brenda vlerave të mëposhtme minimale dhe maksimale të grantit, pa TVSH:

| Vlera minimale e grantit | Vlera maksimale e grantit |
|--------------------------|---------------------------|
| 5,000,000 Lekë | 15,000,000 Lekë |

Nëse janë **dy apo më shumë bashki** që aplikojnë bashkërisht në këtë thirrje për aplikime, çdo grant i kërkuar duhet të jetë brenda vlerave të mëposhtme minimale dhe maksimale të grantit, pa TVSH:


| Vlera minimale e grantit | Vlera maksimale e grantit |
|--------------------------|---------------------------|
| 5,000,000 Lekë | 30,000,000 Lekë |

Kostot e lejuara të projekteve sipas kësaj thirrjeje do të mbulohen 100% kurdo që shuma e projektit është brenda vlerës minimale dhe maksimale të grantit. TVSH e projekteve klasifikohet si kosto e palejueshme dhe do të mbulohet nga vetë përfituesit.

1.4 Përzgjedhja e projekteve, akordimi i grantit dhe pagesa e fondeve të grantit

Skema e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin do të zbatohet në 13 hapa. Në Figurën 1 përcaktohen përgjegjësitë dhe treguesit kohorë për zbatim për secilin hap.

Figure 1. Hapat, përgjegjësitë dhe koha indikative në Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin



2 Rregullat e Skemës së Granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

2.1 Kriteret e lejueshmërisë

Kemi tri nivele të kriterëve të lejueshmërisë që lidhen me:

(1) Aktorët (seksioni 2.1.1):

- Aplikanti kryesor
- Bashkë-aplikant(ët)
- Partner(ët) në projekt

(2) Projektet (seksioni 2.1.2):

- Projektet për të cilat mund të akordohet një grant;

(3) Kostot (seksioni 2.1.3):

- Llojet e kostove që llogariten për të përcaktuar shumën e grantit.

2.1.1 Kriteret e lejueshmërisë për aplikantët (aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikant(ët))

Aplikantët kryesorë dhe bashkë-aplikantët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme për të aplikuar:

1. Të jetë një nga bashkitë, fshatrat e së cilës janë renditur si pjesë e "Programit për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100+ Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026", siç përcaktohet në Shtojcën 1;
2. Të ketë një marrëveshje partneriteti me bashkë-aplikant(të) dhe partner(të) e projektit, nëse ka;
3. Të mos ketë konflikt interesi me Programin ZHRSH (Autoritetin Kontraktues) dhe FSHZH (Enti i Deleguar). Nëse gjatë zbatimit të kontratës lind ndonjë konflikt interesi, përfituesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues.

Aplikanti kryesor duhet:

- Të paraqesë aplikimin;
- Të nënshkruajë kontratën e grantit;
- Të jetë përgjegjësi i drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e Projektit dhe jo të veprjës si ndërmjetës;
- Të menaxhojë fondet e grantit dhe të bëjë të gjitha pagesat në përputhje me aktivitetet dhe kostot e parashikuara;
- Të konfirmojë lejueshmërinë e të gjitha kostove, përfshirë kosto si ato të faturuara nga partneri i projektit, nëse ka.

Bashkë-aplikant(ët) duhet:

- Të zbatojnë aktivitetet e parashikuara në aplikim;
- Të mos vepronë si ndërmjetës;
- Të kenë marrëveshje partneriteti me aplikantin kryesor.

Partnerët e projektit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme për të marrë pjesë:

1. Të jenë organizatë e formës së mëposhtme:
 - 1.1. Organizatë joqeveritare (OJQ) ose jofitimprurëse (OJF) siç janë organizatat për mbështetjen e biznesit, shoqatat e ndërmarrjeve vendore, agjencitë e zhvillimit, shoqatat e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), institucionet arsimore, trajnuese, kërkimore dhe zhvillimore (R&D), shoqatat e punëdhënësve dhe të prodhuesve/zejtarëve; bizneset sociale ose agjenci dhe shoqata të tjera shtetërore dhe publike;
 - 1.2. Operatorë ekonomikë nga sektori privat dhe biznese vendore;
 - 1.3. Komuniteti vendor;
2. Të ushtrojnë veprimtari në zonën gjeografike ku do të zbatohet projekti;
3. Të kenë marrëveshje partneriteti me aplikantin kryesor.

Partnerët e projektit (nëse ka) mund të kontribuojnë edhe financiarisht për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

Bashkia (si aplikant kryesor ose si bashkë-aplikant) mund të aplikojë me më shumë se një projekt propozim brenda vlerës maksimale të buxhetit, siç përcaktohet në seksionin 1.2.

Bashkia (si aplikant kryesor ose si bashkë-aplikant) ka të drejtë të përfitojë vetëm një kontratë granti.

2.1.2 Projektet e lejuara: Projektet për të cilat mund të bëhet aplikimi

Përkufizimi

Projekti përbëhet nga një grup aktivitete.

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e një projekti nuk duhet jetë më shumë se 10 muaj – që nga data e nënshkrimit të kontratës deri në dorëzimin e raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

Vendndodhja

Projektet duhet të zbatohen në territorin e fshatrave të listuara në Shtojcën 1 apo në njësitë administrative pjesë e të cilave janë 100 Fshatrat.

Fusha e ndërhyrjes

Projektet duhet të fokusohen në një ose më shumë nga katër fushat e ndërhyrjes. Fushat e ndërhyrjes janë si më poshtë vijon:

- Zhvillimi i potencialeve të turizmit
- Zhvillimi i ekonomisë vendore
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe ndërveprimit social
- Zhvillimi i shërbimeve publike.

Llojet e projekteve

Llojet e projekteve që mund të financohet në këtë thirrje sipas fushës së ndërhyrjes janë si më poshtë:

Zhvillimi i potencialeve të turizmit

- (1) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të përmirësuar aksesin dhe funksionalitetin e vendeve atraktive natyrore dhe të biodiversitetit.

- (2) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të përmirësuar aksesin dhe funksionalitetin e vendeve atraktive historike dhe kulturore.
- (3) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të krijuar një produkt turistik bazuar në vendet atraktive për aventurë.

Zhvillimi i ekonomisë vendore

- (4) Ndërhyrje për krijimin e mjediseve çlodhëse për sa i përket mikpritjes dhe akomodimit;
- (5) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin dhe promovimin e aktiviteteve ekonomike të ushqimit dhe agro-përpunimit;
- (6) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin dhe promovimin e aktiviteteve ekonomike të produkteve artizanale dhe tradicionale;
- (7) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin e aktiviteteve ekonomike të magazinimit dhe tregtisë.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe ndërveprimit social

- (8) Ndërhyrje me masa mbështetëse² për zhvillimin e aktiviteteve dhe promovimin e vlerave kulturore, historike, të trashëgimisë, gastronomisë dhe turizmit të 100 fshatrave, siç renditen në Shtojcën 1;
- (9) Ndërhyrje me masa mbështetëse për zhvillimin e kapaciteteve veçanërisht për Projektet (4), (5), (6) dhe (7)
- (10) Ndërhyrje me masa mbështetëse për krijimin e partneritetit mes aktorëve të zhvillimit dhe aktorëve të tjerë brenda territorit të mikro rajoneve të 100 fshatrave dhe më tej.

Zhvillimi i shërbimeve publike

- (11) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë dhe/ose masa mbështetëse për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe komunitare.

Për sa i përket projekteve të lejueshme, disa shembuj të projekteve që pranohen për secilën tipologji ndërhyrjeje jepen më poshtë.

Zhvillimi i potencialeve të turizmit

- (1) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të përmirësuar aksesin dhe funksionalitetin e vendeve atraktive natyrore dhe të biodiversitetit.**

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Përmirësimi i aksesit nëpërmjet ndërtimit të shtigjeve natyrore, shtigje për ecje, etj.
- Ndërtimi i infrastrukturës së lehtë turistike, si ballkonet panoramike, shtigjet për biçiklistët, sinjalistikë, shërbime sanitare, zona/fusha pikniku, etj.

- (2) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të përmirësuar aksesin dhe funksionalitetin e vendeve atraktive historike dhe kulturore.**

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Përmirësimi i aksesit nëpërmjet ndërtimit të shtigjeve natyrore, shkallëve, urave prej druri, urave të varura, etj.

² Masa mbështetëse – përshtatur nga termi në anglisht “Soft measures”

- Ndërtim i Infrastrukturës së lehtë turistike në vende të trashëgimisë historike/kulturore, si tabela përshkrimesh, sinjalistikë, shërbimet bazë, etj.

(3) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë për të krijuar një produkt turistik bazuar në vendet atraktive për aventurë.

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Krijimi i parqeve të aventurës për aktivitete të lira në natyrë.
- Krijimi i mjediseve sportive, si itinerare sportive, shërbime mbështetëse përgjatë itinerareve, sinjalistikë, pikat e grumbullimit, mjedise sanitare, etj.
- Ndërtimi i Infrastrukturës së lehtë për krijimin e shtigjeve të sigurta për alpinizëm ekstrem, platforma të fluturimit me parashuta, struktura të ndihmës së shpejtë, etj.

Zhvillimi i ekonomisë vendore

(4) Ndërhyrje për krijimin e mjediseve çlodhëse për sa i përket mikprities dhe akomodimit.

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Krijimi i mjediseve çlodhëse, si vende për kamping/rulo, mjedise për kalimin e kohës së lirë, rikthimin e strukturave të vjetra bujqësore në funksion të agro-turizmit, etj.

(5) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin dhe promovimin e aktiviteteve ekonomike të ushqimit dhe agro-përpunimit.

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Krijimi i mini-punishteve për produktet ushqimore, si prodhime bulmeti, frutash, mishi, etj., si dhe krijimi i një brandi, marketingu, dhe shitja e tyre në nivel vendor.
- Krijimi i mini-punishteve për përpunimin e bimëve mjekësore si dhe krijimi i një brandi, marketingu, dhe shitja e tyre në nivel vendor.

(6) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin dhe promovimin e aktiviteteve ekonomike të produkteve artizanale dhe tradicionale.

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Krijimi i mini-punishteve për përpunimin e drurit, gurit, metalit, lëkurës, tekstilit si dhe i një brandi, marketingu, dhe shitja e tyre në nivel vendor.

(7) Ndërhyrje që fokusohen në forcimin e aktiviteteve ekonomike të magazinit dhe tregtisë.

Shembuj të projekteve që pranohen:

- Ndërtim i Infrastrukturës së lehtë për krijimin e pikave të grumbullimit dhe/ose rikuperimi i atyre ekzistuese, hapësirave të paketimit dhe magazinimit për produktet.
- Ndërtim i Infrastrukturës së lehtë në mbështetje të pikave të përbashkëta të shitjes në fshatra, njësi administrative dhe/ose qarqe, si tregjet fshatare, mjedise për panaire, etj.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe ndërveprimit social

(8) Ndërhyrje me masa mbështetëse për zhvillimin e aktiviteteve dhe promovimin e vlerave kulturore, historike, të trashëgimisë, gastronomisë dhe turizmit të 100 fshatrave.

Shembuj të aktiviteteve që pranohen:

- Organizimi i aktiviteteve promovuese tematike kombëtare dhe vendore, organizimi i tureve promovuese me grupet e interesit, promovimi në media dhe në mediat sociale të vlerave kulturore, historike, të trashëgimisë, gastronomisë dhe turizmit të 100 fshatrave.

(9) Ndërhyrje me masa mbështetëse për zhvillimin e kapaciteteve veçanërisht për Projektet (4), (5), (6) dhe (7)

Shembuj të aktiviteteve që pranohen:

- Ofrimi i asistencës dhe ngritja e kapaciteteve për mikpritjen dhe akomodimin;
- Ofrimi i asistencës dhe ngritja e kapaciteteve për përpunimin, brandimin dhe shitjen e produkteve;
- Ofrimi i asistencës dhe ngritja e kapaciteteve për artizanatin dhe punishtet e artizanatit.

(10) Ndërhyrje me masa mbështetëse për krijimin e partneritetit mes aktorëve të zhvillimit dhe aktorëve të tjerë brenda territorit të mikro rajoneve të 100 fshatrave dhe më tej.

Shembuj të aktiviteteve që pranohen:

- Krijimi i shoqatave sipas natyrës së aktivitetit apo territorit, të tilla si shoqata e artizanëve, shoqata e prodhuesve të bimëve mjekësore, shoqata e përpunuesve të fruta-perimeve, etj.
- Mbështetje për shoqatat ekzistuese dhe/ose ato të reja me hulumtime, informacione, studime, transferim teknologjish, njohuri, etj.

Zhvillimi i shërbimeve publike

(11) Ndërhyrje në infrastrukturën e lehtë dhe/ose masa mbështetëse për përmirësimin e shërbimeve sociale.

Shembuj të aktiviteteve që pranohen:

- Krijimi i qendrave komunitare për qëllime edukimi apo përmirësim kapacitetesh (rinovimi, përshtatja, pajisja e tyre) për të mbështetur më mirë fushat e sipërpërmendura sipas Projekteve (4), (5), (6), (7), (8).
- Krijimi ose përmirësimi i kapaciteteve të ekipeve të kërkim-shpëtimit dhe i vendndodhjeve (organizimi/koordinimi i aktiviteteve për vullnetarët, kurse trajnimi dhe formuese, pajisja e ekipeve dhe vendeve të punës) në territorin e fshatrave/njësive administrative.

Rekomandohet që aplikantët të konsultohen me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për lejueshmërinë e projekteve specifike përveç atyre të përmendura më sipër. Aplikimi mund të përfshijë një tipologji ndërhyrjeje apo aktivitet, ose disa tipologji ndërhyrjeje apo aktivitete të sipërpërmendura.

Projekte që nuk pranohen

Nuk do të pranohen projektet e pjesshme ose ato që kanë filluar tashmë. Projektet që do të financohen nga ky grant nuk duhet të varen nga financime të tjera, si hua apo grante të mundshme. Projektet që financohen nga ky grant nuk duhet të jenë në proces shpronësimi dhe/ose kompensimi për shpronësim.

2.1.3 Lejueshmëria e kostove: kostot që mund të mbuloen nga granti

Vetëm kostot e lejuara do të mbuloen nga grantet e PZHRSH-së. Kategoritë e lejueshme dhe të palejueshme të kostove renditen më poshtë. Buxheti është njëkohësisht vlerësimi i kostosh dhe tavan për 'kostot e lejueshme'. Rimbursimi i kostove të lejueshme do të bazohet në kostot aktuale të kryera nga përfituesi dhe partneri i lejueshëm i përfituesit.

Kostot e lejuara

Kostot e mëposhtme janë të lejueshme:

- Punimet për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e infrastrukturës fizike që është në pronësi të përfituesit ose mirëmbajtja e të cilës është përgjegjësi e përfituesit;
- Blerja e pajisjeve, mobiljeve dhe materialeve që janë ekskluzivisht në ndihmë të punimeve të lartpërmendura;
- Furnizimi me pajisje teknike, mobile dhe infrastrukturë IT;
- Shërbime konsulence, sondazhe, analiza, master plane, etj.;
- Kostot për vizibilitetin dhe eventet e vizibilitetit për aktivitetet e financuara;
- Kostot për organizimin e eventeve, trajnimeve, përfshirë qiranë e ambienteve dhe pajisjeve, materiale mësimi dhe trajnimesh, pushime për kafe, etj.
- Shërbimet për mbikëqyrjen e punimeve (përfshirë edhe kolaudimin);
- Tarifat bankare.

Këto kosto janë të lejueshme, nëse:

- Janë kryer dhe faturuar brenda periudhës së zbatimit të kontratës së grantit;
- Janë prokuruar në përputhje me rregullat në fuqi për prokurimin;
- Si përjashtim, deri në 20% e buxhetit **për konsulencë** mund të faturohet nga partner(ët) e projektit, pas akordimit të drejtpërdrejtë të një kontrate, nëse partneri i projektit është i specializuar dhe me përvojë në ofrimin e një shërbimi të tillë në fushën e zbatimit të projektit (p.sh., përgatitja e sondazheve, studimeve, etj.). Ky partner projekti duhet të japë referenca për të paktën dy aktivitete/shërbime me produkte (output) për aktivitetin/koston (të japë adresën online ose kopje fizike) për të vërtetuar ekspertizën.

Kostot që nuk lejohen

Nuk lejohen kostot e mëposhtme:

- Pagat dhe kosto të tjera operacionale të bashkive apo partnerëve të bashkive përfituese;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzime të kryera përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Kosto për përgatitjen e Projektit;
- Borxhet dhe komisionet e shërbimit të borxhit (interesi);
- Mbulimi i humbjeve ose detyrimeve të mundshme në të ardhmen;
- Kosto të deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një tjetër Projekt nën një tjetër burim financimi;
- Blerje e tokës ose ndërtesave;
- Qira të aseteve;
- Kredi për palë të treta;
- TVSH.

2.2 Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur

2.2.1. Projekt ideja (concept note)

Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet për projekt idenë në formularin e aplikimit për grant, formular që jepet bashkë me këto udhëzime (Shtojca ACN). Aplikimet duhet të jenë në anglisht dhe në shqip.

Lutemi kini parasysh se në projekt idenë, aplikantët kryesorë duhet të japin një vlerë të përafërt të shumës së kërkuar. Buxheti i detajuar do të dorëzohet vetëm kur aplikanti të ftohet të dorëzojë një aplikim të plotë në fazën e dytë.

Aplikanti kryesor nuk mund të zëvendësojë një bashkë-aplikant apo partner të projektit.

Do të vlerësohet vetëm projekt ideja. Prandaj, është e rëndësishme që ky dokument të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me projektin. Nuk duhet të dërgohen shtojca të tjera për projekt idenë.

2.2.1.1. Ku dhe si t'i dërgoni projekt idetë

Të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë 1 (një) aplikim origjinal të firmosur dhe 2 (dy) kopje në formatin A4, secila e kapur veçmas. Projekt ideja duhet të dërgohet edhe në formatin elektronik (me CD-ROM ose USB) në një dokument të vetëm. Dokumentet elektronike duhet të përmbajnë saktësisht të njëjtën projekt ide si varianti në letër i mbyllur në zarf. Që të tri kopjet në letër dhe CD-ROM apo USB-ja duhet të vendosen në një zarf të vetëm të mbyllur.

Deklarata nga aplikanti kryesor, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i bashkisë, duhet të kapet më vete dhe të futet në zarf.

Zarfi duhet të ketë të shkruar titullin e thirrjes për aplikime "SECOND CFP RDPA IV", emrin e plotë dhe adresën e aplikantit kryesor dhe fjalët "Not to be opened before the opening session" dhe "Të mos hapet deri në afatin e përcaktuar".

Bashkitë duhet t'i dërgojnë aplikimet e tyre pranë FSHZH-së. Aplikimet duhen dorëzuar me ane të postës të regjistruar ose dorazi. Në rastin e dorëzimit dorazi, një mandat pranimi i firmosur dhe me datë do t'i jepet dorëzuesit. Aplikimet e dërguara me ndonjë mënyrë tjetër (p.sh., me faks ose me e-mail) ose të dorëzuara në adresa të tjera nuk do të pranohen. Adresa postare e FSHZH-së, si dhe orari i punës, jepen më poshtë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë, Shqipëri

Orari i punës: E hënë – e Enjte 08.00 – 17.00, E premte 08.00 – 14.00

2.2.1.2. Afati për dorëzimin e projekt ideve

Afati për dorëzimin e projekt ideve është data **20 gusht 2021**, siç evidentohet nga data e postimit, nga vula postare ose nga data e mandatit të depozitimit.

Në rastin e dorëzimeve dorazi, afati përfundimtar për dorëzimin është përpara orës **14:00 me orën lokale** siç evidentohet nga mandati me datë dhe i firmosur. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit përfundimtar do të skualifikohet automatikisht.

Autoriteti Kontraktues mund të skualifikojë projekt idetë e dërguara në kohën e duhur, por që mbërrijnë pas afatit përfundimtar si rrjedhojë e vonës postare. Për këtë arsye aplikantët nxiten t'i dorëzojnë projekt idetë e tyre dorazi.

2.2.1.3. Informacione të tjera për projekt idetë

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se data **30 korrik 2021**, në adresën e mëposhtme, duke shënuar qartësisht se i referohen e thirrjes për aplikime "SECOND CFP RDPA IV":

Adresa e-mail: rdpa@rdpa.al

Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime për pyetjet që vijnë pas kësaj date.

Për të siguruar që të gjithë aplikantët të trajtohen në mënyrë të barabartë, Autoriteti Kontraktues nuk do t'u japë asnjë sqarim individualisht aplikantëve për kriteret e pranimit të aplikantëve kryesorë, bashkë-aplikantëve, rreth një projekti apo aktiviteti specifik. Pyetjet që mund të jenë me rëndësi për aplikantët e tjerë, bashkë me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit të PZHRSH: www.rdpa.al dhe faqen e internetit të FSHZH: www.albaniandf.org, sipas rastit dhe nevojës. Prandaj, është e këshillueshme të konsultoheni rregullisht me faqet e internetit të lartpërmendura në mënyrë që të merrni informacione për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

2.2.2. Aplikimi

Aplikimet (vetëm ato që janë zgjedhur paraprakisht) duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet që jepen në formularin e aplikimit për grant dhe në buxhet që janë pjesë e këtyre udhëzimeve. Aplikimet do të jenë vetëm në shqip. Megjithatë, pjesa "Përmbledhje Ekzekutive e Projektit" duhet të jetë si në shqip edhe anglisht.

Çdo gabim apo mospërputhje e rëndësishme në aplikim, për shembull, nëse shumat në tabelat e buxhetit janë të parakorduara (kontradiktore), mund të çojnë në skualifikim të aplikimit.

Sqarimet do të kërkohen vetëm kur informacioni i ofruar është i paqartë dhe, si rrjedhojë, pengon Entin e Deleguar dhe Autoritetin Kontraktues që të kryejnë një vlerësim objektiv.

Aplikimet e dorëzuara me shkrim dore nuk do të pranohen.

Lutemi, vini re se do të vlerësohet vetëm aplikimi për grantin, i hartuar duke plotësuar formularët e publikuar të aplikimit dhe të buxhetit. Prandaj, është e rëndësishme që këto dokumente të përmbajnë TË GJITHË informacionin e nevojshëm sa i përket Projektit. Nuk duhet dërguar asnjë shtojcë tjetër, përveç atyre të kërkuara.

2.2.2.1. Ku dhe si t'i dërgoni aplikimet

Të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë 1 (një) aplikim origjinal të firmosur dhe 2 (dy) kopje në formatin A4 secila e kapur veçmas. Aplikimi i plotë duhet të dërgohet edhe në formatin elektronik (me CD-ROM ose USB) në një dokument të vetëm (d.m.th., aplikimi nuk duhet ndarë në disa file të ndryshme), së bashku me dosjen që përmban buxhetin dhe anekset e kërkuara. Dokumentet elektronike duhet të përmbajnë saktësisht të njëjtin aplikim si varianti në letër i mbyllur në zarf. Që të tri kopjet në letër dhe CD-ROM apo USB-ja duhet të vendosen në një zarf të vetëm të mbyllur.

Lista e kontrollit (seksioni 5 i formularit të aplikimit për grant) dhe deklarata nga aplikanti kryesor, e nënshkruar (emër mbiemër, firmë) nga përfaqësuesi ligjor i bashkisë, (seksioni 6 i formularit të aplikimit për grant) duhet të kapen veçmas dhe të futen në zarf.

Zarf i duhet të ketë të shkruar titullin e thirrjes për aplikime "SECOND CFP RDPA IV", emrin e plotë dhe adresën e aplikantit kryesor dhe fjalët "Not to be opened before the opening session" dhe "Të mos hapet deri në afatin e përcaktuar".

Bashkitë duhet t'i dërgojnë aplikimet e tyre pranë FSHZH-së. Aplikimet duhen dorëzuar me postë rekomande (të regjistruar) ose dorazi. Në rastin e dorëzimit dorazi, dorëzuesit duhet t'i japin një mandat pranimit të firmosur dhe me datë. Aplikimet e dërguara me ndonjë mënyrë tjetër (p.sh., me faks ose me e-mail) ose të dorëzuara në adresa të tjera nuk do të pranohen. Adresa postare e FSHZH-së, si dhe orari i punës, jepen më poshtë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë, Shqipëri
Orari i punës: E hënë – e enjte 08.00 – 17.00; e premte 08.00 – 14.00.

Aplikantët kryesorë duhet të verifikojnë që aplikimi i tyre është i plotë duke përdorur listën e kontrollit (seksioni 5 i formularit të aplikimit për grant). Aplikimet e paplota do të skualifikohen.

2.2.2.2. Afati për dorëzimin e aplikimeve

Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve të plota është data **18 tetor 2021**, siç evidentohet nga data e postimit, nga vula postare ose nga data e mandatit të dorëzimit dorazi.

Në rastin e dorëzimeve dorazi, afati përfundimtar për dorëzimin është përpara orës **16:00 me orën lokale**, siç evidentohet nga mandati me datë dhe i firmosur. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit përfundimtar do të skualifikohet automatikisht.

Autoriteti Kontraktues mund të skualifikojë aplikimet e dërguara në kohën e duhur, por që mbërrijnë pas afatit përfundimtar si rrjedhojë e vonësve postare. Për këtë arsye, aplikantët nxiten të dorëzojnë aplikimin e tyre dorazi.

2.2.2.3. Informacione të tjera për aplikimet

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se **data 29 shtator 2021**, në adresën e mëposhtme, duke shënuar qartësisht se i referohen e thirrjes për aplikime 'SECOND CFP RDPA IV':

Adresa e-mail: rdpa@rdpa.al

Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime për pyetjet që vijnë pas kësaj date.

Për të siguruar që të gjithë aplikantët trajtohen në mënyrë të barabartë, Autoriteti Kontraktues nuk do t'u japë asnjë sqarim individualisht aplikantëve për kriteret e pranimit të aplikantëve kryesorë, bashkë-aplikantëve, rreth një projekti apo aktiviteti specifik. Pyetjet që mund të jenë me rëndësi për aplikantët e tjerë, bashkë me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit të PZHRSH: www.rdpa.al dhe faqen e internetit të FSHZH: www.albaniandf.org, sipas rastit dhe nevojës. Prandaj, është e këshillueshme të konsultoheni rregullisht me faqet e internetit të lartpërmendura në mënyrë që të merrni informacione për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara

2.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Enti i Deleguar nën mbikëqyrjen e Autoritetit Kontraktues. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

Nëse nga shqyrtimi i aplikimeve del se projekti i propozuar nuk përmbush kriteret e pranimit të përcaktuara në Seksionin 2.1, aplikimi do të skualifikohet vetëm për këtë arsye.

HAPI 1: HAPJA, DHE KONTROLLET ADMINISTRATIVE, DHE VLERËSIMI I PROJEKT IDESË

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ do të vlerësohen të mëposhtmet:

- Nëse është brenda afatit. Përndryshe, aplikimi do të skualifikohet automatikisht.
- Nëse projekt ideja trajton të gjitha kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit – projekt ide.

Projekt idetë që kalojnë këtë kontroll do të vlerësohen për rëndësinë dhe hartimin e projektit të propozuar. Projekt idetë do të marrin një pikëzim të përgjithshëm, deri në 100 pikë, duke përdorur ndarjen në tabelën e mëposhtme të vlerësimit.

| Nr. | RËNDËSIA E PROJEKTIT | Pikët maks. |
|-----|---|-------------|
| 1. | Projekti kontribuon në arritjen e një objektivi të caktuar të Skemës së Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (SG ZHRK) <i>Projekti kontribuon plotësisht në arritjen e më shumë se një objektivi të caktuar të SG ZHRK</i> <i>Projekti kontribuon pjesërisht në arritjen e një objektivi të caktuar të SG ZHRK</i> <i>Kontributi për arritjen e një objektivi të caktuar të SG ZHRK është i paqartë / nuk është përshkruar mirë.</i> <i>Nuk evidentohet asnjë kontribut në arritjen e një objektivi të caktuar të SG ZHRK.</i> | 5 |
| 2. | Projekti lidhet me nevojat dhe kufizimet e veçanta të mikro rajonit. <i>Aktivitetet e parashikuara në lidhje me nevojat e mikro rajonit janë përshkruar shumë mirë dhe të justifikuar mirë: ato janë në kohë dhe të përshtatshme</i> <i>Aktivitetet e parashikuara në lidhje me nevojat e mikro rajonit janë përshkruar dhe justifikuar pjesërisht.</i> <i>Aktivitetet janë përshkruar në mënyrë të pamjaftueshme dhe nuk justifikohen mirë për sa i përket nevojave të mikro rajonit.</i> | 5 |
| 3. | Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë kanë lidhje me aktivitetet e projektit, janë evidentuar dhe përcaktuar numerikisht qartë. <i>Grupe të synuara dhe përfitues përfundimtarë të evidentuar qartë dhe me lidhje me projektin, të përcaktuar numerikisht në mënyrë realiste</i> <i>Grupe të synuara dhe përfitues përfundimtarë të evidentuar qartë dhe me lidhje me projektin por numerikisht nuk janë përcaktuar në mënyrë realiste</i> <i>Grupe të synuara dhe përfitues përfundimtarë nuk janë evidentuar qartë dhe numerikisht nuk janë përcaktuar në mënyrë realiste (mungon përshkrimi i lidhjes me projektin dhe përcaktimi sasior)</i> | 5 |
| 4. | Projekti plotëson projektet në vazhdim ose të përfunduara të zbatuara në mikro rajonin si pjesë e programit të zhvillimit kombëtar ose vendor <i>Projekti plotëson projekte në vazhdim në mikro rajon</i> <i>Projekti plotëson projekte të përfunduara në mikro rajon</i> <i>Është projekt i ndarë – nuk është pjesë e asnjë projekti të madh apo nuk lidhet me ndonjë projekt tjetër</i> | 10 |
| 5. | Projekti ka elementë të veçantë me vlerë të shtuar (p.sh., novacione, praktikat më të mira) dhe jep kontribut pozitiv për parimet horizontale: zhvillimi i qëndrueshëm, mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim, barazi mes burrave dhe grave <i>Projekti ka elementë me vlerë të shtuar dhe është koherent me të tre parimet horizontale</i> <i>Projekti nuk ka elementë me vlerë të shtuar por është koherent me dy nga parimet horizontale</i> <i>Projekti nuk ka elementë me vlerë të shtuar dhe nuk është koherent me asnjë parim horizontal</i> | 5 |
| 6. | Ndikimi rajonal dhe përfitimet e projektit <i>Ndikimi rajonal dhe përfitimet e projektit i referohen mikro rajonit</i> <i>Ndikimi rajonal dhe përfitimet e projektit i referohen vetëm partnerit të projektit</i> <i>Ndikim i paqartë mikro rajonal</i> | 5 |
| 7. | Efekti përhapës i projektit <i>Projekti ka potencial të qartë dhe të justifikuar për zhvillim të mëtejshëm</i> | 5 |

| | | | |
|------------|--|----------------|--------------------|
| | <i>Projekti nuk ka potencial të qartë për zhvillim të mëtejshëm, por gjithsesi ka disa ide</i> | <i>2 pikë</i> | |
| | <i>Projekti nuk ka potencial për zhvillim të mëtejshëm</i> | <i>0 pikë</i> | |
| | NËNTOTALI | | 40 |
| Nr. | HARTIMI I PROJEKTIT | | Pikët maks. |
| 8. | Aktivitetet e projektit të propozuar janë të përshtatshme dhe ruhet rrjedha logjike objektiv-aktivitet-rezultat | | 10 |
| | <i>Përputhje e plotë mes objektivit, aktiviteteve dhe rezultateve. Aktivitetet e propozuara janë në përputhje drejtpërsëdrejti me nevojat</i> | <i>10 pikë</i> | |
| | <i>Përputhja mes objektivit, aktiviteteve dhe rezultateve është përshkruar mirë, por mungojnë disa detaje</i> | <i>7 pikë</i> | |
| | <i>Përputhja mes objektivit, aktiviteteve dhe rezultateve nuk është përshkruar shumë mirë.</i> | <i>4 pikë</i> | |
| | <i>Aktivitetet janë tepër teorike dhe është e vështirë të matet arritja e rezultateve të projektit</i> | <i>1 pikë</i> | |
| | <i>Nuk ka përputhje mes aktiviteteve dhe rezultateve të projektit</i> | <i>0 pikë</i> | |
| 9. | Aktivitetet e projektit i referohen fushës (fushave) të lejueshme të ndërhyrjes | | 10 |
| | Aktivitetet e projektit i referohen më shumë se një fushe të lejueshme të ndërhyrjes | <i>10 pikë</i> | |
| | Aktivitetet e projektit i referohen një fushe të lejueshme të ndërhyrjes | <i>5 pikë</i> | |
| | Aktivitetet e projektit nuk i referohen asnjë fushe të lejueshme të ndërhyrjes | <i>0 pikë</i> | |
| 10. | Projekti paraqet një analizë të plotë të problemeve që trajton dhe të kapaciteteve të partnerëve përkatës¹ | | 10 |
| | Projekti paraqet një analizë të plotë të problemeve që trajton dhe të kapaciteteve të partnerëve përkatës | <i>10 pikë</i> | |
| | Projekti paraqet një analizë të dobët të problemeve që trajton dhe të kapaciteteve të partnerëve përkatës | <i>5 pikë</i> | |
| | Nuk bëhet asnjë një analizë e problemeve që trajtohen dhe të kapaciteteve të partnerëve përkatës | <i>0 pikë</i> | |
| 11. | Aktivitetet janë të realizueshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme (përfshirë afatin kohor) | | 10 |
| | Aktivitetet janë të realizueshme dhe përkojnë me rezultatet e pritshme (përfshirë afatin kohor) dhe rezultatet (produktet, rrjedhojat dhe ndikimi) janë realiste | <i>10 pikë</i> | |
| | Aktivitetet janë të realizueshme dhe përkojnë me rezultatet e pritshme (përfshirë afatin kohor), por rezultatet (produktet, rrjedhojat dhe ndikimi) nuk janë realiste | <i>5 pikë</i> | |
| | Aktivitetet nuk janë të realizueshme dhe nuk përkojnë me rezultatet e pritshme (përfshirë afatin kohor) dhe rezultatet (produktet, rrjedhojat dhe ndikimi) nuk janë realiste | <i>0 pikë</i> | |
| | NËNTOTALI | | 40 |
| Nr. | PARTNERITETI | | Pikët maks. |
| 12. | Sigurohet përfshirja e bashkë-aplikantëve dhe partnerëve të projektit për zbatimin e projektit. | | 10 |
| | Aplikanti kryesor aplikon me bashkë-aplikant dhe me partner projekt | <i>10 pikë</i> | |
| | Aplikanti kryesor aplikon vetëm me bashkë-aplikant | <i>7 pikë</i> | |
| | Aplikanti kryesor aplikon vetëm me partner projekt | <i>3 pikë</i> | |
| | Aplikanti kryesor aplikon vetëm, pa asnjë partner | <i>0 pikë</i> | |
| 13. | Shtjellohet përfshirja e partnerëve për zbatimin e Projektit | | 10 |
| | Përfshirja e partnerëve për zbatimin e Projektit shtjellohet shumë mirë, duke ofruar informacion të hollësishëm për rolin dhe funksionin e partnerit për arritjen e objektivit të projektit. | <i>10 pikë</i> | |
| | Përfshirja e partnerëve për zbatimin e Projektit shtjellohet, por nuk ofrohet informacion i | <i>7 pikë</i> | |

| | | | |
|--|--|--------|------------|
| | hollësishëm për rolin dhe funksionin e partnerit për arritjen e objektivit të projektit. | | |
| | Përfshirja e partnerëve për zbatimin e Projektit nuk shtjellohet mirë, dhe informacioni për rolin dhe funksionin e partnerit për arritjen e objektivit të projektit është i paqartë. | 4 pikë | |
| | Nuk ka partnerë të përfshirë për zbatimin e projektit. | 0 pikë | |
| | NËNTOTALI | | 20 |
| | TOTAL | | 100 |

Vetëm projekt idetë që kanë marrë të paktën 60 pikë do të konsiderohen për përzgjedhje paraprake.

Numri i projekt ideve do të reduktohet, duke marrë parasysh renditjen, deri në numrin e projekt ideve, shuma totale agregate e vlerave të kërkuara të të cilave arrin deri në 200% të buxhetit në dispozicion për këtë thirrje për propozime.

Pas vlerësimit të projekt ideve, Autoriteti Kontraktues do t'u dërgojë një letër secilit aplikant kryesor, duke i thënë nëse aplikimi i tyre ishte dërguar brenda afatit, duke i informuar për numrin e referencës që iu është caktuar aplikimit të tyre, nëse projekt ideja është vlerësuar si dhe do t'i u bëjë të ditur rezultatet e këtij vlerësimi. Aplikantët kryesorë të përzgjedhur paraprakisht do të ftohen të paraqesin aplikimin e plotë.

HAPI 2: HAPJA DHE KONTROLLI ADMINISTRATIV DHE VLERËSIMI I APLIKIMIT TË PLOTË

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ do të vlerësohen të mëposhtmet:

- Nëse dorëzimi është bërë brenda afatit. Përndryshe, aplikimi do të skualifikohet automatikisht.
- Nëse aplikimi i plotë përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit të projektit të plotë.

Aplikimet e plota që kalojnë këtë kontroll do të vlerësohen për cilësinë, përfshirë edhe buxhetin e propozuar. Ato do të vlerësohen në përputhje me tabelën e mëposhtme të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit fokusohen në cilësinë e aplikimit për sa i përket rëndësisë së projektit, përputhshmërisë së tij me objektivat e thirrjes për propozime, ndikimit e pritshëm, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin.

| Nr. | RËNDËSIA E PROJEKTIT | Pikët maks. | |
|-----|---|-------------------|--------|
| 1. | <i>Pikët e transferuara nga vlerësimi i Projekt Idesë – seksioni i rëndësisë së projektit</i> | Deri në 40 | |
| | NËNTOTALI | Deri në 40 | |
| Nr. | EFEKTIVITETI, ZBATUESHMERIA DHE QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT | Pikët maks. | |
| 2. | Kuadri logjik përshin të dhëna bazë të besueshme, objektiva dhe burime verifikimi | 5 | |
| | Kuadri Logjik ka të dhëna bazë të besueshme, objektiva dhe burime verifikimi, të cilat do të bëjnë të mundur një monitorim dhe vlerësim të përshtatshëm të zbatimit të projektit. | | 5 pikë |
| | Kuadri Logjik ka objektiva dhe burime verifikimi, por baza e të dhënave duhet të përcaktohet duke u mbështetur në një studim bazë të parashikuar në projekt. | | 3 pikë |
| | Të dhënat, objektivat dhe/ose burimet e verifikimit nuk janë përcaktuar qartë në kuadrin logjik, gjë që do të bëjë të pamundur monitorimin e përshtatshëm dhe vlerësimin e zbatimit të projektit. | | 1 pikë |

| | | | |
|------------------|--|---------|-----------|
| 3. | Plani i veprimit për zbatimin e Projektit është i qartë, i zbatueshëm dhe afati kohor është realist | | 5 |
| | Plani i veprimit për zbatimin e projektit është i qartë, i zbatueshëm dhe afati kohor është realist, gjë që do të sigurojë arritjen e objektivave të parashikuar brenda afatit të projektit. | 5 pikë | |
| | Plani i veprimit për zbatimin e projektit është i qartë dhe i zbatueshëm, ndërsa afati kohor nuk është aq realist, gjë që mund të ketë ndikim negativ në arritjen e objektivave të parashikuar brenda afatit të projektit. | 3 pikë | |
| | Plani i veprimit për zbatimin e projektit është i paqartë, ndërsa afati kohor nuk është realist, gjë që do të ketë ndikim negativ në arritjen e objektivave të parashikuar brenda afatit të projektit. | 0 pikë | |
| 4. | Plani i prokurimit është i zbatueshëm dhe i lidhur me dokumentet e prokurimit (dosja e tenderit, përfshirë preventivin e punimeve; specifikimet teknike për materialet dhe termat e referencës për shërbimet) | | 15 |
| | Plani i prokurimit është realist dhe të gjitha dokumentet përkatëse të prokurimit janë përpunuar plotësisht duke bërë të mundur kështu nisjen e prokurimit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit. | 15 pikë | |
| | Plani i prokurimit është realist dhe të gjitha dokumentet përkatëse të prokurimit janë përpunuar plotësisht duke bërë të mundur kështu nisjen e prokurimit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit, edhe pse nevojiten përmirësime të vogla, që mund të trajtohen gjatë fazës së kontraktimit. | 12 pikë | |
| | Plani i prokurimit është realist. Disa dokumente duhet të shtjellohen më tej në mënyrë që prokurimi të nisë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. | 9 pikë | |
| | Plani i prokurimit nuk është realist. Disa dokumente duhet të shtjellohen më tej në mënyrë që prokurimi të nisë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. | 5 pikë | |
| | Plani i prokurimit nuk është realist. Pjesa më e madhe e dokumenteve duhet të shtjellohen më tej në mënyrë që prokurimi të nisë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. | 2 pikë | |
| 5. | Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit | | 5 |
| | Projekti parashikon aktivitete/mjete komunikimi dhe vizibiliteti për audiencën e gjerë (niveli rajonal dhe vendor) | 5 pikë | |
| | Projekti parashikon disa aktivitete/mjete komunikimi dhe vizibiliteti, por audienca është e kufizuar (komuniteti vendor) | 3 pikë | |
| | Projekti nuk parashikon aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti. | 0 pikë | |
| 6. | Projekti bashkë-financohet nga partner(ë) të projektit?³ | | 5 |
| | Po | 5 pikë | |
| | Jo | 0 pikë | |
| 7. | Qëndrueshmëria e rezultateve/produkteve të pritshme pas përfundimit të projektit dhe kapaciteti i përfituesit për t'i zbatuar ato. | | 5 |
| | Rezultatet/produktet kryesore të projektit pritet të japin një kontribut të rëndësishëm dhe afatgjatë në zgjidhjen e sfidave të synuara | 5 pikë | |
| | Rezultatet/produktet kryesore të projektit pritet të kenë efekt pozitiv për zgjidhjen e sfidave të synuara, por në periudhë afatshkurtër. | 3 pikë | |
| | Disa aktivitete të projektit pritet të japin efekt pozitiv por qëndrueshmëria mbetet e paqartë. | 2 pikë | |
| | Rezultatet/produktet kryesore të projektit nuk kanë potencial për qëndrueshmëri afatgjatë. | 0 pikë | |
| NËNTOTALI | | | 40 |

³ Bashkëfinancimi do të thotë fonde shtesë të siguruar nga partneri i projektit, bazuar në marrëveshjen zyrtare të partneritetit me aplikantin kryesor dhe bashkë-aplikantin nëpërmjet të cilit partneri i projektit angazhohet për të siguruar fonde shtesë përtej shumës së grantit (që nuk kanë të bëjnë me kostot e TVSH-së të mbuluara nga bashkia) për zbatimin e projektit.

| Nr. | BUXHETI DHE EFIKASITETI I PROJEKTIT | Pikët maks. |
|-----|---|-------------|
| 8. | <p>Buxheti i propozuar është i lidhur drejtpërdrejtë dhe përkon me aktivitetet e projektit.</p> <p><i>Të gjitha kostot e parashikuara përkojnë plotësisht me aktivitetet e propozuara dhe janë të nevojshme për zbatimin e projektit.</i></p> <p><i>Shpenzimet e projektit i tejkalojnë përfitimet e pritshme për zonat e synuara dhe grupet e synuara. Disa kosto nuk janë të rakorduara me aktivitetet e propozuara.</i></p> <p><i>Kostot e parashikuara janë tërësisht të parakorduara me aktivitetet e projektit.</i></p> | 8 |
| 9. | <p>Kostot llogariten sipas çmimeve aktuale të tregut</p> <p><i>Të gjitha kostot llogariten sipas çmimeve aktuale të tregut apo manualeve zyrtare.</i></p> <p><i>Disa kosto nuk llogariten sipas çmimeve aktuale të tregut, kështu që rishikimi ose reduktimi i pjesëshëm i çmimeve për njësi do të përmirësojë shumë efektivitetin e kostos.</i></p> <p><i>Pjesa më e madhe e kostove nuk llogariten sipas çmimeve aktuale të tregut. Buxheti ka nevojë për rishikim të plotë në këtë aspekt.</i></p> | 7 |
| 10. | <p>Zbërthimi i detajuar i zërave të buxhetit është në përputhje me llojin e ndërhyrjes dhe rregullat për secilin zë buxhetor respektohen</p> <p><i>Zbërthimi i detajuar i zërave të buxhetit është në përputhje me logjikën e ndërhyrjes dhe rregullat specifike për secilin zë buxhetor respektohen.</i></p> <p><i>Zbërthimi i zërave të buxhetit dhe rregullat specifike për secilin zë buxhetor respektohen pjesërisht.</i></p> <p><i>Zbërthimi i zërave të buxhetit dhe/ose rregullat e veçanta për secilin zë buxhetor nuk respektohen.</i></p> | 5 |
| | NËNTOTALI | 20 |
| | TOTAL | 100 |

Përzgjedhja e përkohshme

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku do të listohen aplikimet e renditura në përputhje me pikët që kanë marrë. Aplikimet që kanë marrë më shumë pikë do të përzgjidhen përkohësisht derisa të përdoret buxheti në dispozicion për këtë thirrje për aplikime

Në rastin e aplikimeve me të njëjtat pikë, përparësi në listë do t'u jepet aplikimeve që kanë marrë më shumë pikë në seksionin 2 të Tabelës së Vlerësimit që jepet më sipër, dhe në rast të pikëve të njëjta edhe në seksionin 2, atyre që kanë marrë më shumë pikë në seksionin 3 të Tabelës së Vlerësimit. Në rast të pikëve të njëjta edhe për seksionet 2 dhe 3, atëherë përparësi do t'i jepet pikëve që janë dhënë në seksionin 1.

Përveç kësaj, do të hartohet një listë rezervë duke ndjekur të njëjtat kritere. Kjo listë do të përdoret nëse më shumë fonde do të vihen në dispozicion.

Çdo aplikim i skualifikuar do të zëvendësohet nga aplikimi pasues i renditur më mirë në listën rezervë, aplikim vlera e të cilit ndodhet brenda buxhetit në dispozicion për këtë thirrje për aplikime.

2.4 Njoftim për vendimin e Autoritetit Kontraktues

2.4.1 Përmbajtja e vendimit

Aplikantët kryesorë do të informohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktues sa i përket aplikimit të tyre dhe, nëse skualifikohet, arsyet e vendimmarrjes negative.

Aplikanti që beson së është dëmtuar nga një gabim apo parregullsi gjatë procesit të akordimit të grantit mund të një bëjë një ankesë.

Në vendim do të përfshihet edhe lista e dokumenteve shoqëruese shtesë që duhen mundësuar me qëllim nënshkrimin e kontratës së grantit, si dhe afatin përfundimtar për të dorëzuar këto dokumente. Mosdorëzimi brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues i dokumenteve shoqëruese shtesë mund të çojë në skualifikim të aplikimit.

2.4.2 Paraqitja e dokumenteve shoqëruese për aplikimet e përzgjedhura përkohësisht

Dokumentet shoqëruese të mëposhtme duhen dorëzuar nga aplikantët e përzgjedhur përkohësisht si kusht për të vijuar më tej me përgatitjen e kontratës së grantit:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak i aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantit, nëse ka, për të zbatuar Projektin për të cilin është akorduar granti i PZHRSH, vendim ku autorizohet Kryetari i Bashkisë për të nënshkruar kontratën e grantit;
- Për projektet e investimit, konfirmim për pronësinë e pasurisë së paluajtshme ose prova të tjera me dokumente që vërtetojnë të drejtën ligjore për të përdorur pronën përkatëse publike;

Dokumentet shoqëruese duhen dorëzuar në formën e origjinalit, apo varianteve të certifikuara të fotokopjeve apo të skanuara (d.m.th., të shfaqen të lexueshme qartësisht vulat, firmat dhe datat) të origjinaleve të përmendura më sipër.

Nëse dokumentet shoqëruese të përmendura më sipër nuk dorëzohen përpara afatit të shënuar në kërkesën për dokumentet shoqëruese që i është dërguar aplikantit kryesor nga Autoriteti Kontraktues, aplikimi mund të skualifikohet.

2.5 Tabela me afatet kohore

| | DATA | ORA |
|--|----------------|--|
| 1. Lançimi dhe publikimi i Thirrjes për Aplikime | 15 korrik 2021 | |
| 2. Seanca informimi në rajonet zhvillimore | 26 korrik 2021 | 26 korrik 2021 – Bashkitë e Rajonit nr.3, Korçë (18 bashki) |
| | 27 korrik 2021 | 27 korrik 2021 - Bashkitë Rajonit nr.1, Shkodër (11 bashki) (TBC) |
| | 28 korrik 2021 | 28 korrik 2021 – Bashkitë e Rajonit nr.2, Tiranë (12 bashki) (TBC) |
| | 29 korrik 2021 | 29 korrik 2021 – Bashkitë e Rajonit nr. 4, Vlorë (20 bashki) |

| | | |
|---|---|--|
| 3. Seanca informimi online nga Njësitë Rajonale të FSHZH | 30 Korrik 2021 | Workshope për Bashkitë sipas secilit rajon zhvillimor |
| 4. Vlerësimi i koncept notave nga Enti Deleguar, FSHZH | 23 Gusht – 3 Shtator 2021 | |
| 5. Shpallja e vendimit për aplikuesit e përzgjedhur për të dorëzuar aplikimin e plotë nga Autoriteti Kontraktues | 6-16 Shtator 2021 | |
| 6. Udhëzime për aplikantët mbi përgatitjen e projekt-propozimeve | 23,24,27,28 shtator 2021 | Workshope për aplikantët e përzgjedhur për të dorëzuar aplikimin e plotë |
| 7. Afati përfundimtar për të kërkuar sqarime tek Autoriteti Kontraktues | 30 korrik 2021 – për projekt idenë 29 shtator 2021 – për aplikimin e plotë | Posta elektronike do të pranojë pyetje deri në orën 23.59 |
| 8. Data e fundit në të cilën jepen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues | 2 Gusht 2021- për projekt idenë 1 Tetor 2021- për aplikimin e plotë | |
| 9. Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve | 20 Gusht 2021 – për projekt idenë 18 tetor 2021 – për aplikimin e plotë | 14.00 16.00 |
| 10. Vlerësimi i aplikimeve të plota | 19 tetor – 3 Nëntor 2021 | |
| 11. Shpallja e vendimit për fituesit e granteve (përfshi periudhën e ankimimit) | 4 - 26 Nëntor 2021 | |
| 12. Procedura e kontraktimit | 22 Nëntor – 3 Dhjetor 2021 | |
| 13. Nënshkrimi i kontratës | 6 - 15 dhjetor 2021 | |

Të gjithë treguesit e orës përkohë me orën e Shqipërisë.

Këto afate kohore treguese i referohen datave indikative (përveç pikat 1, 2, 7, 8 dhe 9) dhe mund të përditësohen nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës. Në raste të tilla, afatet e përditësuara do të publikohen në faqen e internetit të PZHRSH www.rdpa.al dhe faqen e internetit të FSHZH www.albaniandf.org.

2.6 Nënshkrimi i kontratës së grantit

Nënshkrimi i kontratës së grantit parashikohet maksimalisht brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të akordimit të grantit (shpalljes së fituesit). Si rrjedhojë, pas marrjes dhe verifikimit të dokumenteve shoqëruese, Autoriteti Kontraktues do të përgatisë kontratën e grantit dhe t'ia dërgojë atë aplikantit të përzgjedhur. Aplikanti i

përzgjedhur do të nënshkruajë kontratën dhe do t'ia dërgojë sërish Autoritetit Kontraktues, brenda afatit të përcaktuar

2.7 Kushtet për zbatimin pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për akordimin e grantit

Në vijim të vendimit për të akorduar një grant, përfituesi(t) do t'i(u) ofrohet një kontratë granti e panegociueshme. Aplikimi i dorëzuar nga aplikanti, përfshirë modifikime që mund të kërkohen nga Komisioni i Vlerësimit, do të bëhet shtojcë e kontratës së grantit.

Aty ku zbatimi i Projektit kërkon që përfituesi(t) të lidhin kontrata prokurimi, ato kontrata duhen lidhur në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3 LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Listë e mikro rajoneve të lejueshme për Programin “100 fshatrat”

DOKUMENTET QË DUHEN PLOTËSUAR:

Shtojca ACN: Formulari i Aplikimit për Grant – Projekt Ide (në format Word-i)

Shtojca A: Formulari i Aplikimit për Grant – Aplikimi i plotë (në format Word-i)
– kjo do të bëhet Shtojca I e Kontratës së Grantit së bashku me Kuadrin Logjik

Shtojca A1: Kuadri logjik (në format Word-i)

Shtojca B: Buxheti (në format Excel-i) – kjo do të bëhet Shtojca II e Kontratës së Grantit

Shtojca C: Kontratë tip i Grantit

Shtojca D: Marrëveshje tip partneriteti për projektin